Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

ANALIZA E TREGUT TË MJEDRËS

Shtator, 2019

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE

ANALIZA E TREGUT TË MJEDRËS

Shtator, 2019

Parathënie

Mjedra është njëra ndër kulturat bujqësore që bënë pjesë në grupin e manoreve dhe që viteve të fundit paraqitet si kulturë mjaft fitimprurëse në Kosovë. Si e tillë paraqet njërën ndër kulturat me rëndësi strategjike që ka mundësi të shtimit të sipërfaqeve të mbjellura, rritjen e prodhimtarisë dhe njëherit eksportimin e këtij produkti në vende të ndryshme. Kultivimi i kësaj kulture kontribuon dukshëm në reduktimin e papunësisë në zonat rurale, rritjen e të ardhurave të fermave individuale dhe kështu, mund të ndikoj në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ringjalljen e zhvillimit ekonomik në zonat rurale. Sipërfaqja e kultivuar me këtë kulturë ka pasur rritje në vitet e fundit.

Mjedra është ndër kulturat me kthim të shpejtë të investimeve, me mundësi të favorshme për zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara, tregtimin për nevoja të tregut lokal e po ashtu edhe për tregjet e huaja si e freskët, e ngrirë apo e përpunuar. Kjo analizë është punuar nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore dhe ka për qëllim ofrimin e një dokumenti i cili ka të përmbledhura të gjitha të dhënat lidhur me tregun e mjedrës në Kosovë. Në këtë analizë ku për bazë janë marrë statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, paraqiten të dhënat për sipërfaqen, prodhimtarinë vendore, çmimet e mjedrës, madhësinë e tregut, koston e investimit, mbështetjen e kulturës së mjedrës si dhe konkluzionet e përgjithshme.

1 Tregu i mjedrës

Mjedra viteve të fundit është dëshmuar që është një ndër frutat me rëndësi të madhe ekonomike. Edhe pse është e kultivuar në sipërfaqe të vogël, ka mundësi të mëdha të zgjerimit, duke marrë për bazë kushtet e favorshme natyrore, duke ofruar sasi të mjaftueshme si për tregun lokal ashtu edhe për eksport. Sipas të dhënave nga ASK, sipërfaqja e kultivuar me mjedër është rritur dukshëm ndër vite. Në vitin 2018, të mbjellura me mjedër ishin 1,537 ha, apo shtim i sipërfaqes për 306 ha krahasuar me vitin 2017. Meqenëse prodhimtaria e mjedrës është sezonale dhe kemi kryesisht afro 4 muaj prodhimtari të mjedrës së freskët, për plotësimin e kërkesave vendore paraqitet nevoja edhe për import edhe pse në sasi të vogël.

Figura 1: Sipërfaqja e mbjellur me mjedër sipas regjioneve (ha), 2014



Burimi: ASK - Regjistrimi i bujqësisë 2014, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Bazuar në të dhëna e Regjistrimit të Bujqësisë që është realizuar në vitin 2014, vërehet se më së shumti sipërfaqe e kultivuar me mjedër ishte në regjionin e Ferizajit (30%), pasuar nga regjioni i Prishtinës (26%), Prizrenit (25%), Gjakovës (9%), Gjilanit (5%), Mitrovicës (4%) dhe më së paku në regjionin e Pejës (1%).

2 Prodhimtaria vendore

Nisur nga aspekti biologjik dhe agro-ekologjik, kërkesave teknike dhe teknologjike, diversitetit të përdorimit dhe mundësisë së tregtimit, në kushtet e Kosovës, mjedra është kulturë me mundësi të mëdha zhvillimi dhe prodhimi i mjedrës në Kosovë po kalon në një periudhë rritjeje të shpejtë. Mjedra është duke u kultivuar në të gjithë Kosovën. Vendet me prodhim më të lartë janë: Podujeva, Ferizaj dhe Shtërpca si dhe vise tjera të Kosovës.

Me ndihmën e projektit të realizuar nga "Caritas-i" Zviceran, ka filluar edhe kultivimi i mjedrës organike në bashkëfinancim me Komunën e Dragashit me tentativë të zgjerimit të kësaj prodhimtarie edhe në komunat tjera. Qëllimi i skemës së grantit është që të mundësojë mbështetjen financiare për fermerë të komuniteteve të ndryshme për kultivimin e mjedrës organike, me mundësi të zgjerimit.

Në vitin 2018, sipërfaqja e plantacioneve të pemëve ishte 7,922 ha, nga kjo sipërfaqe me mjedër ishin të kultivuara 1,537 ha, me pjesëmarrje prej 19% të sipërfaqes së mbjellur me pemë në vendin tonë. Prodhimtaria e mjedrës që u arrit gjatë vitit 2018 ishte 8,267 tonë, apo rritje të prodhimit për 7% në krahasim me vitin 2017.

Duke filluar nga viti 2013, kur ishin mbjellura 23 ha sipërfaqe me mjedër, me prodhimtari prej 105 tonë, trendi i rritjes së sipërfaqes vazhdoi në vitet në vijim. Në vitin 2014 ishin të mbjellura 141 ha, në vitin 2015 ishin 324 ha, duke vijuar me trend të rritjes edhe në vitin 2016, kur kjo sipërfaqe arriti në 797 ha. Rritje më të madhe të sipërfaqes së mbjellur për këtë periudhë kohore kishte në vitin 2018, me 306 ha më shumë, që del të jetë një zgjerim i sipërfaqes së mbjellur me këtë kulturë për 38% për dallim nga viti 2017.

Figura 2: Sipërfaqja e kultivuar me mjedër në ha, 2012-2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Prodhimtaria e mjedrës në vitin 2012 ishte vetëm 1 tonë, duke vazhduar me rritje në vitin 2013 ku kjo prodhimtari u rrit në 105 tonë dhe 529 tonë në vitin 2014. Në vitin 2015 pati rritje për më tepër se trefishi krahasuar me vitin 2014, ku vërehet rritje shumë më e theksuar në vitin 2016 me 6,250 tonë mjedër të prodhuar. Kjo rritje vazhdoi edhe në vitin 2017 ku u arrit sasia e prodhimit prej 7,747 tonë.

Prodhimi i mjedrës pati trend të rritjes edhe në vitin 2018, ku gjatë këtij viti kishte prodhimtari në sasi prej 8,267 tonë.

Figura 3: Prodhimtaria e mjedrës në tonë, 2012-2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Rendimenti i mjedrës në vitin 2013 ishte 4.6 tonë/ha, që vazhdoi me rënie në vitin 2014 në 3.7 tonë/ha. Rendimenti më i lartë arrit në vitin 2016, me sasia të prodhimit prej 7.8 tonë/ha. Në vitin 2017 kishte rënie të rendimentit (6.3 tonë/ha) dhe kjo rënie vazhdoi edhe në vitin 2018 ku rendimenti për hektar ishte 5.4 tonë.

Figura 4: Rendimenti i mjedrës (tonë/ha), 2012-2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3 Zhvillimi i tregtisë

Kosova gjatë periudhës së prodhimit vendor të mjedrës, mund të përmbush nevojat për konsum vendor, duke marrë për bazë vlerësimet e ekspertëve vendor, ku sipas tyre afro 96% e sasisë së prodhimit të mjedrës së grumbulluar në pikat grumbulluese, shkon për eksport dhe vetëm 4% gjendet si e freskët për konsum vendor dhe për përpunim. Përveç përkrahjes së nivelit qendror përmes pagesave direkte dhe granteve, gjithashtu ka pasur përkrahje edhe nga niveli komunal, ku disa prej tyre kanë ndihmuar fermerët për kultivimin e mjedrës. Përveç nivelit qendror dhe lokal, prodhimtaria e mjedrës është përkrahur edhe nga USAID dhe donatorë të tjerë. Në vitin 2018 prodhimi i përgjithshëm i mjedrës ishte 8,267 tonë, nga e cila sasi është arritur të eksportohen 1,714 tonë dhe janë importuar 143.4 tonë, kryesisht nga Serbia (99.5%).

3.1 Importi i mjedrës

Në figurën në vijim është prezantuar sasia e importit të mjedrës për vitet 2012-2018, ku viti 2018 ishte vit që vlen të ceket si kishte import të mjedrës (143.5 tonë) për dallim nga vitet e tjera ku sasia ishte shumë simbolike apo më pak se 2 tonë. Kjo ishte si rezultat i rendimentit të ulët të mjedrës vendore për vitin 2018, që erdhi si pasojë e kushteve klimatike, reshjeve dhe vërshimeve të mëdha gjatë vegjetacionit. Në vitin 2017, vlera e importit të mjedrës ishte 4.4 mijë €, deri sa periudha paraprake (2012-2016) u karakterizua me vlerë shumë më të vogël të importit. Vlera e importit në vitin 2018 ishte 195.9 mijë € dhe me çmim për njësi të importuar 1.37 €/kg.

Figura 5: Importi i mjedrës 2012-2018, në tonë (majtas) dhe në '000 € (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Për shkak të levërdisë ekonomike shumica e prodhuesve kanë të kontraktuar prodhimin e mjedrës me pikat e mëdha grumbulluese. Shteti kryesor prej nga është importuar mjedra e freskët në vitin 2018 me pjesëmarrje prej 99.5% ka qenë Serbia,

ndërsa vetëm 0.5% e importit ishte nga vendet tjera. Sasia e importit të mjedrës së freskët në vitin 2017 ishte kryesisht nga tri shtete: Serbia me pjesëmarrje dominuese prej 78%, Shqipëria 20% dhe nga Greqia vetëm 2%.

Figura 6: Sasia e importit të mjedrës së freskët në vitin 2018 (majtas) dhe 2017 (djathtas), sipas vendeve (%)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Përveç sasisë së mjedrës (të freskët dhe të ngrirë) të importuar në vitin 2018, gjithashtu ka pasur edhe import të mjedrës së procesuar si pure dhe pasta si dhe forma tjera të mjedrës së përpunuar në sasi prej 17.8 tonë. Shtetet prej nga është importuar sasia e mjedrës së procesuar janë: Turqia me pjesëmarrje më të madhe në sasi të importit prej 80%, Gjermania 11.2%, Austria 6.3%, Belgjika 2.2% dhe të tjera 0.3%.

Figura 7: Shtetet prej nga është importuar sasia e mjedrës së procesuar, 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.2 Eksporti i mjedrës

Bazuar në informatat që janë prezantuar në figurën 8 vërejmë së në vitin 2012 ka pasur 89 tonë eksport, duke vazhduar me rënie të sasisë në vitin 2013 në 53 tonë. Sasia e eksportit është shtuar në vitet 2014, 2015 dhe 2016 ku janë eksportuar mbi 100 tonë mjedër. Shtim të eksportit në krahasim me eksportin e periudhës 2012-2016 ka pasur në vitin 2017, ku sasia e eksportit arriti në 1,640 tonë, duke vijuar me rritje te konsiderueshme të eksportit edhe në vitin 2018 që ishte 1,714 tonë. Sasia e mjedrës së eksportuar në vitin 2018 ishte më e madhe për 4.5% në krahasim me vitin 2017.

Figura 8: Eksporti i mjedrës 2012-2018, në tonë (majtas) dhe në '000€ (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Vlera e eksportit në vitin 2012 ishte 150 mijë €, më rënie të vlerës në 89 mijë € në vitin 2013, duke vazhduar me rritje në vitin 2014 në 230 mijë €. Rritja vazhdoi edhe në vitin 2015 ku vlera e eksportit të mjedrës ishte 451 mijë €, duke vazhduar me rënie në vitin 2016 në 373 tonë.

Pasi që edhe sasia e mjedrës së eksportuar ishte më e madhe në vitin 2017 vlera e eksportit u rrit në 2.4 mil. €, duke pësuar rënie në vitin 2017, ku kjo vlerë arriti në 2.3 mil €.

Edhe pse në vitin 2018 kishte sasi më të madhe të eksportit se sa në vitin 2017, megjithatë, vlera ishte më e ulët pasi që çmimi grumbullues për njësi/kg ishte më i ulët për 0.11 €.

Gjatë vitit 2018 vendi ynë eksportoi mjedër në sasinë prej 1,714 tonë, nga e cila sasi në Gjermani u eksportua 76% apo pjesa më e madhe e mjedrës së eksportuar, pasuar nga Serbia 12%, Hungaria 11%. Sasi e vogël e eksportit të mjedrës prej 1% u eksportua në Austri dhe në Zvicër vetëm 0.03%.

Figura 9: Sasia e eksportit të mjedrës sipas vendeve, 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në vitin 2017 u eksportua sasi e mjedrës prej 1,601 ton. Përkundër faktit se kjo sasi ishte më e vogël se sa në vitin 2018, mirëpo u eksportua në shumë ma tepër vende se sa në vitin 2018. Edhe në vitin 2017 pjesa dërmuese e mjedrës është eksportuar në Gjermani (46%), Serbi (21%), në Hungari dhe Austri (12%), Itali (5%), Francë dhe Holandë 1%, si dhe në Lituani 0.3%.

Figura 10: Sasia e eksportit të mjedrës sipas vendeve, 2017



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.3 Bilanci tregtar i mjedrës

Nga të dhënat e prezantuara rrjedh se bilanci tregtar i mjedrës gjatë periudhës 2012-2018 ishte pozitiv me rritje të konsiderueshme ndër vite. Në vitin 2018 kishte eksport në vlerë prej 2.3 mil. €, kurse importi arriti vlerën 0.2 mil. €, duke rezultuar me bilanc tregtar pozitiv prej 2.1 mil. € në vitin 2018. Duke filluar nga viti 2012 e deri në vitin 2017 bilanci tregtar i mjedrës kishte trend të vazhdueshëm të rritjes, kur edhe u arrit pika më e lartë e eksportit me bilanc pozitiv prej 2.4 mil. €.

Në vitin 2018 kishte rënie të vlerës së eksportit për 3.6% krahasuar me vlerën e vitit 2017 dhe njëherit edhe bilanc tregtar më të ulët në vitin 2018 për 11.5%.

Figura 11: Vlera e bilancit tregtar për mjedrën, 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

4 Çmimet e tregut

Në vendin tonë viteve të fundit tregu i mjedrës është duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme. Popullata është vetëdijesuar për vlerat e shumta nutritive të mjedrës, që përveç se është e njohur si frut i shijshëm edhe me vlera të shumta ushqyese, gjithashtu mund të përpunohet dhe të ruhet për periudhë më të gjatë kohore. Një sasi e prodhimit të mjedrës të prodhuar në vendin tonë kryesisht eksportohet në tregun e jashtëm, në vendet e regjionit dhe në ato të BE-së, ndërsa pjesa tjetër përdoret për konsum familjar apo shitet në tregun vendor. Çmimet ndryshojnë nga viti në vit, varësisht nga sasia e prodhimit që gjendet në treg, si në atë vendor, në regjion e më gjerë.

4.1 Çmimet në tregun vendor

Prodhimi i mjedrës është i pranishëm për treg nga muaji Qershor deri në muajin Tetor, derisa të paraqiten temperaturat më të ulëta se 2°C. Kultivarët më të përhapur të mjedrës ishin Polka, Willamette dhe Miker. Kultivari Polka konsiderohet si një ndër kultivarët më të përhapur në sipërfaqen e përgjithshme të Kosovës që mbjellet me mjedër me pjesëmarrje rreth 80%, i cili njëherësh është edhe kultivari më profitabil

dhe më i përshtatshëm për kushtet agro-klimatike të Kosovës. Në figurën në vijim janë paraqitur çmimet mesatare të tregut vendor me pakicë dhe shumicë gjatë periudhës kohore 2012-2018.

Figura 12: Çmimet e tregut vendor të mjedrës, 2012-2018, €/kg



Burimi: SIT, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Çmimi mesatar me shumicë i mjedrës vendore për vitet 2012-2018 ishte 2.82 €, më i ulëti ishte 2.10 €/kg në vitin 2015 dhe më i larti në vitet 2017 dhe 2018 që arriti vlerën 3.38 €. Sikurse çmimi me shumicë i mjedrës po ashtu edhe ai me pakicë ka pasur ndryshime të vazhdueshme nga viti në vit, varësisht nga sasia dhe kualiteti i produktit në treg. Mesatarja e çmimit të mjedrës e shitur me pakicë për periudhën kohore 2012-2018 ishte 3.07 €/kg.

Në vitin 2018 çmimi i mjedrës arriti në 3.89 €/kg, që po ashtu ishte çmimi më i lartë për këtë periudhë kohore të paraqitur në figurë, ndërsa më i ulëti paraqitet në vitin 2015, ku çmimi mesatar vjetor i mjedrës ishte 2.27 €/kg. Sa i përket çmimit mesatar të fermës më i larti është shënuar në vitin 2015 që kishte vlerë 1.80 €/kg, ndërsa ai më i ulëti paraqitet në vitin 2018 në çmim prej 0.80 €/kg. Çmimi mesatar i eksportit ka pasur luhatje ndër vite, por çmimi më i lartë për njësi të eksportuar u arrit në vitin 2015 ku është shënuar vlera prej 2.38 €/kg, duke vazhduar me rënie në 1.90 €/kg, në vitin 2016, në 1.47 €/kg në vitin 2017, vijuar nga viti 2018 me çmim edhe më të ulët që ishte 1.36 €/kg.

4.2 Çmimet e importit

Luhatshmëria në çmimet aktuale të blerjes mund të ndryshojë shumë nga viti në vit. Ky ndryshim i madh i çmimeve është pjesërisht për shkak të prodhimit të madh në vende që janë udhëheqëse në Evropë dhe në regjion në prodhimtarinë e mjedrës dhe lidhjes së shkëputur me industrinë përpunuese në vendin tonë. Për përmbushjen e kërkesave të tregut vendor për mjedër jashtë sezonës së prodhimtarisë vendore është importuar një sasi e vogël e mjedrës së freskët dhe asaj të përpunuar. Mesatarja e çmimit me shumicë për njësi të importuar të mjedrës së freskët apo të ngrirë për vitet 2013-2018 ka qenë 3.40 €/kg, kurse çmimi mesatar vjetor me pakicë për njësi të importuar për vitet 2013-2018 ishte 3.82 €/kg, ndërsa për ato të procesuara çmimi mesatar vjetor arriti në 2.54 €/kg.

5 Madhësia e tregut

Shfrytëzimi i fondeve të ndryshme nga ana e fermerëve që synon kryesisht ngritjen e objekteve të prodhimit dhe magazinimin apo ruajtjen e prodhimit për kohë më të gjatë, kontribuon në rritjen e konkurrencës dhe zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara me fruta të imëta-manore. Gjendja është përmirësuar edhe nga fakti se fermerët janë organizuar në grupe dhe organizata prodhuesish. Ekzistojnë shoqata të vogla të organizuara në regjione të Kosovës që janë të bashkuara në shoqatën "Mjedra" e cila financohet nga projektet e USAID-it. Kjo shoqatë bashkon grupe të ndryshme të prodhuesve të frutave manore që marrin njohuri paraprake lidhur me kultivimin e mjedrës dhe ndihmën rreth grumbullimit dhe eksportimit të produktit.

Madhësia e tregut të përgjithshëm të mjedrës në Kosovë në vitin 2018 duke përfshirë prodhimtarinë vendore dhe importin vlerësohet të jetë 8,427 tonë, nga e cila sasi 8,267 tonë janë prodhimtari vendore. Në anën tjetër importi i mjedrës si produkt i freskët ose i përpunuar ishte 144 tonë, si dhe mjedër e përpunuar në formë të puresë dhe pastave dhe formave tjera të përpunimit 17 tonë.

6 Kostoja e prodhimit të mjedrës

Nga të dhënat e prezantuara për sipërfaqen e mjedrës së kultivuar në Kosovë vërehet se ka pasur rritje nga viti në vit, derisa në vitin 2018 janë shumëfishuar krahasuar me vitet paraprake. Për shkak të rritjes së sipërfaqeve, teknologjisë dhe varieteteve të përmirësuara, kultivuesit e mjedrës kanë shumëfishuar edhe prodhimin e mjedrës. Që nga viti 2014, kur është filluar me subvencionim edhe të kulturave manore, ndër to edhe mjedra, është nxitur zgjerimi i këtij sektori me hapa të shpejtë. Sipas përllogaritjes së profitabiliteti për kulturën e mjedrës sipas operacioneve të nevojshme si dhe prodhimtaria për hektar, për ngritjen e një hektari me kultivar pranveror gjithsej shpenzimet janë afërsisht 15,165 €, varësisht nga çmimet që varirojnë nga viti në vit. Të ardhurat në vitin e parë janë afro 6,850 € ose 4,000 kg prodhim. Në Vitin e dytë gjithsej shpenzime ishin 5,835 €, ndërsa të ardhura ishte 13,600 € mjedra të shitura. Gjatë llogaritjes së profitabilitetit për vitin e tretë apo viti i frytdhënies së plotë del se fitimi neto për një ha në frytdhënie të plotë është 16,425 €.

6.1 Ndikimi i prodhimtarisë së mjedrës në punësim dhe mundësia e krijimit të vendeve të reja të punës

Numri i fermerëve që kultivojnë mjedër llogaritet të jetë 4,786 dhe mesatarisht posedojnë sipërfaqe prej 0.61 ha. Për kultivimin e mjedrës në të gjitha fazat e prodhimtarisë ishin të angazhuar në punë më tepër se 3,125 punëtor me orar të plotë. Ekzistojnë mbi 13 qendra të mëdha të grumbullimit dhe shumë të tjera me madhësi më të vogël. Pikat grumbulluese më të mëdha mesatarisht mund kenë grumbulluar 292 tonë mjedër të freskët.

Në shoqatën "Mjedra" afro 67% e çmimit të eksportit shkon për vetë fermerët. Në treg janë aktive diku rreth 10 kompani që bëjnë furnizimin me material fidanor të mjedrës, duke sjellur në treg 6 lloje të varieteteve të mjedrës.

7 Mbështetja e prodhimtarisë së mjedrës

7.1 Pagesat direkte për mjedër

Programi i zhvillimit të sektorit sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, parasheh rritjen e konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor. Mbështetja direkte e sipërfaqeve të tokës bujqësore të mbjellura me pemë do t'i kontribuojë realizimit të këtij objektivi. Sigurimi dhe siguria e ushqimit, si dhe rritja e të ardhurave të fermerëve janë edhe arsyet e përkrahjes së këtij sektori, ruajtja dhe zgjerimi i sipërfaqeve me pemë, ndalimin e migrimit nga zonat rurale në zonat urbane si dhe duke

marrë për bazë numrin e madh të fermerëve të cilët merren me këtë sektor dhe resurset natyrore të cilat i ka vendi. Fermerët të cilët kultivojnë pemë për të qenë përfitues nga programi i pagesave direkte duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, të kenë të mbjellura së paku 0.20 ha me pemë të imëta (dredhëz, mjedër, manaferrë, aroni dhe boronicë), parcela e mbjellur në pronësi apo e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë, sipërfaqja e pemishtes së kontraktuar duhet të jetë së paku për një vit, pemishtja duhet të jetë e mirëmbajtur (e lëvruar ose e mbjellur me bari në mes të rreshtave, e krasitur, e mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve-rreshtave. Subvencionimi në formë të pagesave direkte do të bëhet për sipërfaqe (ha) të mbjellur, në vlerë prej 400 €/ha.

7.2 Masat e zhvillimit rural që përkrahin sektorin e pemëve-mjedra

Në kuadër të masave të zhvillimit rural në vitin 2018 kultura e mjedrës është përkrahur në kuadër të masës 101, Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore. Objektiva të përgjithshme të kësaj mase janë: rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit, krijimi i vendeve të reja të punës, përkrahja e bujqve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së, përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, si dhe adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme. Objektivat specifike që kanë të bëjnë me sektorin e pemëve janë: rritja e prodhimit të pemëve për qëllime komerciale, modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja, zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim, prodhimi i energjisë së ripërtëritshme. Fermerët në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 1 hektar, sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.35 hektar. Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë 11 fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit. Gjithashtu fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 3,000 € ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100,000 €. Në kuadër të masës 101, sektori i pemëve mjedra përkrahet edhe në kuadër të masës 103, Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore. Vlera minimale e shpenzimeve

të pranueshme për projekt është 30,000 €, ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 400,000 €. Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit. Përveç masës 101 dhe 103 sektori i pemëve përkrahet edhe në kuadër të masës 302, Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve. Masa 302 "Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve" synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe ruajtjen e atyre ekzistuese. Në kuadër të investimeve të pranueshme hyjnë: ndërtimi / renovimi / zgjerimi i objekteve për prodhim, ruajtje dhe përpunim të prodhimeve, investimet në makina dhe pajisje për përpunimin e pemëve dhe perimeve, klasifikim, grumbullim, ruajtje, frigorifer me ftohje, me ngrirje etj, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nën masat e kësaj mase është 5,000 €. Përkrahja publike është 65% e shpenzimeve të pranueshme të investimit. Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore.

8 Promovimi dhe sfidat

Kultura e mjedrës si kulturë me potencial zhvillues, krahas zhvillimit intensiv në vitet e fundit, ka nevojë për promovim në tregun lokal si dhe promovim të eksportit, si mjedër e përpunuar. Në vitet e fundit në kuadër të politikave për zhvillim dhe promovim të sektorit të pemëve është bërë promovimi i mjedrave të freskëta. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me USAID-in, ka arritur që paralel me prodhimin kulminant të mjedrës të shënoj edhe javën promovuese të mjedrave "Java e mjedrave", i cili organizohet tradicionalisht çdo vit. Po ashtu rëndësi për promovimin e mjedrës ka pjesëmarrja e prodhuesve në panaire të produkteve bujqësore që organizohet çdo vit radhazi. Sfidë kryesore për kultivuesit e mjedrës që vazhdimisht ballafaqohen është mungesa e fidanëve cilësor të prodhuar sipas standardeve të larta ndërkombëtare, gjë që në mungesë të cilësisë së tyre ka pasur raste kur fusha të tëra të mbjellura me mjedër janë shkatërruar. Po ashtu mungesa e sistemit të ujitjes paraqet sfidën e radhës për fermerët. Ballafaqimi i vazhdueshëm me kushtet klimatike, dëmet të cilat herë pas here po shkaktohen nga breshëri dhe vërshimet. Vështirësi kryesisht për kultivuesit e mjedrës në zonat më pak të favorizuara është mungesa e frigoriferëve ku mund ta ruajnë prodhimin për kohë më të gjatë dhe produktin e tyre ta shesin me çmim më të favorshëm.

9 Konkluzionet

Në analizën e mësipërme për kulturën e mjedrës shihet se e ardhmja e prodhimtarisë dhe industrisë për përpunimin e pemëve në këtë rast grupit të pemëve manore, respektivisht mjedrës, si potencial konkurrues në regjion mund të fuqizohet dhe të jetë prioritet në planifikime për zhvillim në të ardhmen. Ky sektor mjaft i rëndësishëm mundëson dhe realizon të ardhura të mira për ekonomitë bujqësore, ofron rikthim të shpejtë dhe profitabil të investimit, krijon dhe gjeneron vende të reja të punës, si dhe kontribuon në ekonominë e përgjithshme të vendit.

Si kulturë mjedra ka përparësi për kushtet tona klimatike, pasi që lulëzon më vonë dhe më pak dëmtohet nga ngricat e vonshme pranverore.

Kultivimi i mjedrës është i një rëndësie të madhe kur merret parasysh fakti se kjo kulturë përveç se konsumohet si produkt i freskët për ushqim, ka përdorim dhe ka treg të gjerë në shumë fusha tjera si në industrinë ushqimore, industrinë e pijeve alkoolike dhe joalkoolike, industrinë kozmetike dhe përdorime të tjera. Përmes masave të mbështetjes për prodhuesit, është duke u rritë profitabiliteti nga investimet për këtë kulturë. Prandaj përveç përkrahjes së kësaj kulture përmes formës së subvencioneve nga niveli qendrorë duhet të ketë përkrahje edhe nga ai komunal dhe po ashtu edhe projektet duhet të orientohen në përkrahje të kësaj kulture, siç është rasti i fillimit të përkrahjes së mjedrës organike nga Caritasi Zviceran në komunën e Dragashit. Duke u bazuar në kërkesat e tregut me zgjerimin e sipërfaqeve të mjedrës organike fermerët do të fitonin një çmim më të mirë dhe gjithë prodhimi do të mund të eksportohej në formë të kontraktuar .

Sfidë e madhe për prodhuesit vendor që kultivojnë mjedrën janë sigurimi i materialit të pastër fidanor të certifikuar, ruajtja e frutit për një periudhë më të gjatë kohore si dhe hallka e shkëputur e zingjiirit të vlerës së prodhimit në mungesë të kapaciteteve përpunuese në vend.